



KONFERENCË SHTYPI MË 19 MAJ 2000.

1. ÇFARË ËSHTË BËRË DHE ÇFARË NUK ËSHTË BËRË MIRË NË VITIN 1999 DHE NË KATËRMUJORIN E VITIT 2000 NGA BANKA E SHQIPËRISË ?

Në zbatim të ligjit është forcuar pavarësia e Bankës së Shqipërisë për realizimin e objektivit kryesor të veprimtarisë së saj “arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve”. Është sukses, tashmë i padiskutuar, kalimi nga një inflacion prej më shumë se 42 për qind në vitin 1997 në një nivel pranë 0 në fund të vitit 1999 dhe mbajtja në thuajse të njëjtët kufij, deri në fund të muajit prill 2000.

Me nivelin e inflacionit në fund të muajit prill, si dhe duke ditur sjelljen sezonale të çmimeve të konsumit, në kushtet e ecjes normale (pa eksese) të situatës politiko-ekonomike të vendit, ***konsiderohet i arritur objektivi prej 2-4 për qind i inflacionit për vitin 2000.***

Faktorët, që përcaktojnë këtë nivel inflacioni, për vitin 1999 dhe katërmujorin 2000, janë të shumtë, si forcimi i disiplinës fiskale, ecuria e kursit të këmbimit (faktori me ndikimin më të madh sasiar), politika e duhur monetare e zbatuar nga Banka e Shqipërisë. Në uljen e inflacionit kanë ndikuar edhe tkurrja e kreditimit të investimeve, niveli i inflacionit të importuar, “ambientimi” i publikut me një inflacion të ulët etj..

Ndikimi i politikës monetare, në këtë drejtim, matet me respektimin e tre objektivave sasiarë: kufirit të poshtëm për mjetet e huaja neto të Bankës së Shqipërisë, kufirit të sipërm për mjetet e brendshme neto të Bankës së Shqipërisë dhe kredisë neto të sistemit bankar për qeverinë. Të tre këta objektiva, janë respektuar si gjatë vitit 1999 edhe në katërmujorin e parë të vitit 2000. Nga ana tjetër, norma minimale për depozitat me afat tremujor ka pësuar një reduktim të ndjeshëm nga 37 për qind, në vitin 1997, në 7 për qind, aktualisht. Normat e tanishme të interesit janë në nivelin historik më të ulët të arritur nga viti 1992. Këto vendime janë marrë duke u bazuar në zhvillimet në çmimet e konsumit, në forcimin e vlerës së lekut dhe në ecurinë e depozitave në sistemin bankar. Ato kanë si synim uljen e kostos së financimit në ekonomi, të kostos së shërbimit të borxhit të qeverisë dhe, në afat më të gjatë, nxitjen e rritjes ekonomike.

Megjithatë, vlen të theksohet, që çdo vendim i marrë për uljen e normave të interesit është bazuar edhe në interesin për të ruajtur besimin e depozituesve në sistemin bankar, duke ruajtur norma pozitive interesi në terma realë. Niveli mesatar vjetor i interesit real për depozitat me afat njëvjeçar, në fund të muajit prill, është 5,2 për qind.

Vendimet e Bankës së Shqipërisë për uljen e normës së interesit janë shoqëruar me ulje të ndjeshme të *yield*-it të bonove të thesarit. Në harkun kohor të 16 muajve të fundit, niveli i *yield*-it u ul përkatësisht 8.16, 7.58 dhe 8.99 pikë përqindjeje për bonot e thesarit me maturim tre, gjashtë dhe dymbëdhjetëmuor. Në tërësi, vërehet që subjektet, që veprojnë në tregun e letrave me vlerë të qeverisë, kanë reaguar në përputhje me vendimet e Bankës së Shqipërisë dhe pas një periudhe kohe të arsyeshme. Kjo ka ndodhur, sepse ky treg funksionon dhe është ndër tregjet më aktive në Shqipëri. Aktualisht *yield*-i i bonove të thesarit është 11.9 për qind, 13,5 për qind dhe 14 për qind, përkatësisht për bonot me afat maturimi tre, gjashtë e dymbëdhjetëmuor, pra, në një nivel shumë më të lartë se depozitat bankare për të njëjtat afate.

Nuk mund të thuhet e njëjta gjë për tregun e huadhënies. Reduktimi i normave të interesit për depozitat, nuk është shoqëruar me rritje të nivelit të huadhënies. Për më tepër, kostoja mesatare e kreditimit nga 40-45 për qind, në vitin 1997 u ul në 25 për qind në fund të vitit 1998 dhe mbeti thuajse në të njëjtin nivel mesatar deri tani. Por, me përjashtim të një banke, që është dhe me aktivja në kreditim, thuajse të gjitha bankat e tjera, aktualisht, ofrojnë kredi me interesa 18-20 për qind, pra me ulje të ndjeshme nga interesat e ofruar pak muaj më parë.

Banka e Shqipërisë, në muajin nëntor 1999, mori vendimin për heqjen e kufirit të kreditimit për bankat e nivelit të dytë. Por, përsëri, kreditimi për vitin 1999 mbeti në nivele mjaft të ulëta. Efektet e para të fushatës, të mbështetur dhe nga bankat, nuk kanë munguar. Siç u përmend më lart, veç shenjave drejt uljes së interesave të kredisë në disa nga bankat ka dhe një rritje të nivelit të kreditimit.

Kështu, në tre muajt e parë të vitit 2000, sipas të dhënave operative, kredia gjithsej për sektorin privat është rritur rreth 1,6 miliardë nga 2,2 miliardë lekë që ishte gjatë gjithë vitit 1999. Nëse ruhet ky temp, duket, do të kemi afro trefishin e kredisë së dhënë nga sistemi bankar.

Ecuria e sistemit bankar dhe e politikës monetare jepet më në detaje në Raportin Vjetor të Bankës së Shqipërisë, dërguar zyrtarisht më 31 mars



2000 në Kuvendin Popullor e në Qeveri dhe raportuar në datën 4 maj 2000 në Kuvend. Kopje të këtij raporti ju keni tashmë këtu, prandaj, fare shkurt, më lejoni të hedh një vështrim mbi ç'ka ka ndodhur tjetër në sistemin bankar shqiptar.

Së pari, gjatë vitit 1999 filluan aktivitetin tre banka të reja private, Banka Fefad, Dega në Tiranë e Bankës së Parë të Investimeve dhe Banka Ndërtregtare. Kjo është tregues i një besimi, relativisht më të madh, të investitorëve për të investuar në tregun bankar shqiptar. Vetëm Banka Fefad i shtoi portofolit të huave të sistemit bankar rreth 700 milionë lekë.

Së dyti, është zgjeruar numri i degëve në rrethe. Gjatë vitit 1999 janë çelur dy degë bankash dhe tre agjenci.

Së treti, megjithëse është i pranishëm deformimi i tregut bankar dhe monopoli i Bankës së Kursimeve, po forcohet tendenca që të rritet roli i bankave private, duke premtuar për një funksionim më normal dhe më efikas të këtij tregu në të ardhmen. Banka e Kursimeve, në fund të vitit 1998, kishte 69,3 për qind të tregut bankar (totalit të bilancit) në fund të vitit 1999, 67,9 për qind dhe në 31.03.2000 kishte 64,1 për qind.

Së katërti, gjatë vitit 1999, sistemi bankar përmirësoi situatën financiare të tij. Nëse në fund të vitit 1998, rezultati financiar ishte negativ për 3.3 miliardë lekë, në fund të vitit 1999, sistemi bankar rezultoi me fitim për 1.3 miliardë lekë. Madje edhe rezultati neto nga interesat që historikisht ka qenë negativ, në fund të vitit 1999 është pozitiv për 5.2 miliardë lekë. Edhe në tremujorin e parë të vitit 2000 sistemi paraqitet me fitim.

Së pesti, është forcuar pozicioni i kapitalit në banka për disa arsye. Më 31 mars 1998 Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori vendimin për rritjen e kapitalit minimal të paguar për bankat ekzistuese në 500 milionë lekë, brenda muajit shtator 1999. Këtë vendim e respektuan pothuaj të gjitha bankat. Vetëm tri prej tyre nuk e respektuan dot afatin. Nisur nga shkaqet dhe kushtet e mosrespektimit, Banka e Shqipërisë miratoi shtyrjen e këtij afati deri në shkurt të vitit 2000 për njëren bankë dhe deri në fund të vitit 2000 për dy bankat e tjera. Afati i ri i vendosur është respektuar. Kështu, kapitali i nënshkruar për krejt sistemin bankar është paguar në masën 90 për qind të tij. Niveli i kapitalit të bankave pritet të rritet si pasojë e zbatimit të vendimit tjetër të Bankës së Shqipërisë, që kapitali i paguar të arrijë masën 700 milionë lekë deri në fund të muajit mars të vitit 2001. Nga ana tjetër, është reduktuar ndjeshëm

mungesa e kapitalit në grupin e bankave shtetërore dhe, për pasojë, edhe në sistemin bankar. Megjithatë, grupi i bankave shtetërore vazhdon të ketë pamjaftueshmëri kapitali si pasojë e humbjeve të trashëguara nga vitet e kaluara.

Por, viti 1999 nuk shënoi ndonjë përmirësim cilësor në lidhje me zhvillimin e sistemit të pagesave. Në përgjithësi, sistemi i pagesave ka të njëjtat probleme si edhe vite më parë: nivel i lartë i qarkullimit të *cash*-it, vonesa në transferimin e parave, sidomos brenda vendit, diferenca të mëdha në teknologji, si dhe në shtrirjen e rrjetit në sistemin bankar shqiptar etj..

Përveç rritjes së volumit të transaksioneve, si pasojë kryesisht e zgjerimit të sistemit bankar me banka dhe degë të reja, disa nga bankat private futën në përdorim instrumente të reja pagesash si ATM, kartën DINERS CLUB dhe VISA, etj., por që ende kanë përdorim të ulët. Niveli i ulët i zhvillimit të sistemit të pagesave në Shqipëri është një faktor shtesë, që mban larg klientët nga bankat. Banka e Shqipërisë ka përgjegjësinë e vet në këtë drejtim dhe ajo është e angazhuar, në kuadër të Komitetit Kombëtar të Pagesave, si dhe nëpërmjet inicimit të disa projekteve në fushën e pagesave, për të kontribuar në këtë drejtim (projektet RTGS, sistemi i kleringut i standardeve etj.).

2. KALIMI NGA INSTRUMENTET DIREKTE NË ATO INDIREKTE PËR ZBATIMIN E POLITIKËS MONETARE.

Zhvillimet e fundit në tregun e parasë (në vitet 1999 dhe 2000) kanë treguar **nevojën e domosdoshme** për kalimin nga përdorimi i instrumenteve direkte në ato indirekte për zbatimin e politikave monetare. Ky kalim nuk do të jetë një proces i menjëhershëm e i thjeshtë, por do të kërkojë kohë, ndërgjegjësim e mirëkuptim nga të gjithë pjesëmarrësit e tregut të parasë e ,më konkretisht, nga depozituesit e thjeshtë, sipërmarrësit, bankat e nivelit të dytë, Ministria e Financave si dhe vetë Banka e Shqipërisë. Në këtë kuadër, nuk duhet të lihet mënjanë dhe media e shkruar e vizive, e cila me “**interpretimin e informacioneve të ndryshme**” mund ta shpejtojë ose ta vonojë këtë proces duke ndikuar direkt në koston dhe në kohën e realizimit të tij. Gjithashtu, duhet të theksojmë se të gjithë pjesëmarrësit e tregut do të përfitojnë nga ky kalim pavarësisht se për momentin mund të duket jo shumë i prekshëm e larg interesave të tyre. Nëpërmjet realizimit të tij do t'i jepet fund mënyrave administrative të menaxhimit të situatave, duke lejuar forcat e tregut **të realizojnë qëllimet e tyre specifike** në treg.



Mund të thuhet, se ky proces tashmë ka filluar që në nëntor të vitit 1999, kur Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë *de facto* **hoqi kufirin e kreditit (instrument direkt i politikës monetare, instrument kontrolli për cilësinë e bankave)**. Duke hedhur këtë hap, ju dha mundësia bankave të nivelit të dytë të kreditojnë ekonominë në bazë të analizave, që ato vetë kryenin për tregun dhe situatën në vend si dhe të kërkesave, që vinin nga vetë tregu. Në të njëjtën kohë, nga ana e Bankës së Shqipërisë, ishte punuar paraprakisht për të rritur cilësinë dhe efikasitetin e kontrollit të sistemit bankar. Heqja e këtij instrumenti u shoqërua dhe me fillimin e një fushate për rritjen e nivelit të kreditimit të ekonomisë. Në raportimin që u bë në Kuvendin Popullor, në fund të vitit 1999, u bë e qartë politika e Bankës së Shqipërisë në këtë drejtim.

Zhvillimet, e fillimit të vitit 2000, nxorën në pah se ulja e normave të interesit, nga ana Bankës së Shqipërisë, nuk po jep efektin e pritshëm në sistemin bankar dhe në ekonomi. Kjo, për shkak të krijimit të “një hendeku” midis politikës, që Banka e Shqipërisë kërkon të zbatojë dhe ndjerjes së saj deri nga segmentet më të fundit, depozituese e sipërmarrëse, për të ndikuar, në këtë mënyrë, në raportin kursim/konsum.

Mbushja e këtij hendeku do të shpejtohet nëpërmjet **kalimit nga përdorimi i normës minimale të interesit, instrumenti i vetëm direkt i mbetur, në instrumentet indirekte**. Ky kalim bëhet më i nevojshëm po të marrim në konsideratë politikën, që po ndjek Qeveria Shqiptare, në drejtim të bankave shtetërore (qëllimi përfundimtar privatizimi i tyre). Duke marrë në konsideratë gjendjen aktuale si dhe domosdoshmërinë e realizimit me sukses të këtij procesi është planifikuar një bashkëpunim intensiv me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore, gjatë vitit 2000 e në vazhdim.

Në këtë aspekt, nga ana e Bankës së Shqipërisë, po punohet në tre drejtime kryesore e më konkretisht:

- 1- përmirësimin e tregut të bonove të thesarit;
- 2- rritjen e konkurrencës në tregun e parasë;
- 3- përmirësimin e instrumenteve në dispozicion të bankës për zbatimin e politikës monetare.

Eshtë filluar me **përmirësimin e tregut të bonove të thesarit** pasi ato do të shërbejnë si bazë e të gjitha instrumenteve indirekte, që do të përdoren në tregun e parasë dhe janë më të prekshme nga publiku.

- Në këtë kuadër, u ndryshua rregullorja e emetimit të bonove të thesarit në tregun primar si dhe rregulloret, që rregullojnë

- tregtimin e tyre në tregun sekondar e me pakicë. Qëllimi i vetëm i këtyre ndryshimeve ka qenë rritja e fleksibilitetit dhe pakësimi i pengesave burokratike në tregtimin e tyre.
- Gjatë tremujorit të parë është punuar dhe në drejtim të ndërgjegjësimit e informimit të tregut nëpërmjet shkrimeve të ndryshme në median e shkruar, organizimin e seminareve për bonot e thesarit me sportelistët e të gjitha bankave të nivelit të dytë si dhe është hapur faqe speciale në internet për bonot e thesarit. Kjo fushatë do të vazhdojë nëpërmjet botimeve të ndryshme, që do të dalin në shtyp.

Rezultatet nuk kanë munguar si në drejtimin e rritjes së numrit të pjesëmarrësve ashtu dhe në drejtim të shumës, që ata angazhojnë për të investuar në bono thesari.

Përsa i përket **rritjes së nivelit të konkurrencës** në treg qëllimi kryesor i Bankës së Shqipërisë do të jetë heqja e pozicioneve monopol gjë, që do t'i hapë rrugën veprimit të forcave të tregut për përcaktimin e çmimit të huamarrjes e të huadhënies së monedhës kombëtare. Nëpërmjet realizimit me sukses të kësaj lëvizjeje, Banka e Shqipërisë, do ta ketë më të lehtë të gjykojë mbi situatën në treg dhe veprimet, që ajo duhet të ndër marrë, për të arritur targetin e saj përfundimtar.

Në drejtim **të përmirësimit të instrumenteve**, që do të përdoren për zbatimin e politikës monetare, Banka e Shqipërisë, ka bërë përmirësimet e nevojshme në aspektin rregullativ, por ka shumë për të bërë në drejtim të efektivitetit të përdorimit të tyre. Ajo ka si synim që të punojë me interesat afatshkurtër dhe të lërë tregun të vendosë për nivelin e interesave afatgjatë brenda horizontit njëvjeçar (6 dhe 12 muaj). Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë, po hedh hapa konkretë. Në mbledhjen e fundit të Këshillit Mbikëqyrës u vendos heqja e normës minimale për depozitat gjashtëmujore. Përsa i përket rritjes së efektivitetit në përdorimin e instrumenteve, ka filluar puna për ndërgjegjësimin e sistemit bankar e njëkohësisht gjetjen e mirëkuptimit nga bankat.

3. PËR KREDITIMIN E EKONOMISË DHE FUSHATËN E KREDITIT. GJENDJA E KREDITIMIT NË FUND TË TREMUJORIT TË PARË TË VITIT 2000.

Kreditimi i ekonomisë nga ana e sistemit bankar, në përgjithësi, gjatë 9 vjetëve të fundit, ka qenë në nivele të ulta. Vendimet e herëpashershme të Bankës së Shqipërisë për uljen e normave të interesit për depozitat me afat në lekë nuk janë shoqëruar ndjeshëm edhe me uljen e normave



të interesit të kredidhënies nga ana e bankave. Kështu, në vitin 1999 në krahasim me një vit më parë, diferenca midis interesit mesatar të kredive dhe depozitave me afat maturimi një vit, është rritur gati dy herë (nga 8.5 pikë përqindjeje në 16.7 pikë përqindjeje).

Gjatë vitit 1999, në programin monetar të Bankës së Shqipërisë, kufiri i kreditit për ekonominë ishte caktuar 8 miliardë lekë dhe në fund të vitit rezultoi se gjendja e kredive në sistemin bankar ishte rritur rreth 2.2 miliardë lekë ose 27.5 për qind e totalit të kufirit të kreditit. Kjo tregoi, jo vetëm nivelin e ulët të kredidhënies, por edhe faktin se kufiri i kreditit, si instrument direkt i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë, nuk përbënte tashmë një pengesë për bankat. Për këtë arsye, në muajin nëntor 1999, Banka e Shqipërisë mori vendimin e heqjes së kufirit të kreditit për bankat e nivelit të dytë.

Mund të përmenden mjaft arsye për mosdhënien e kredive. Por, më të rëndësishme paraqiten:

- * rreziku i lartë i kreditit në Shqipëri gjë që i bën bankat private mjaft konservatore në këtë aktivitet;
- * bizneset shqiptare nuk punojnë me bankat, si të tilla ato nuk janë kliente të sigurta për to;
- * bizneset shqiptare, gjithashtu, kanë një shkallë të ulët transparence në marrëdhëniet me bankat, duke u bërë pak të besueshme për to;
- * pengimi i bankave shtetërore për të dhënë hua si pasojë e nivelit të lartë të huave të këqija në këto banka dhe nisur nga nevoja për t'i mbrojtur ato nga pësimi i humbjeve të mëtejshme, që do të rrisnin koston e privatizimit;
- * mosfunksionimi efikas i sistemit gjyqësor dhe përmbarues;
- * pengesat në regjistrimin e pronave etj.;
- * mungesa e prezencës së bankave në të gjithë territorin e vendit;
- * *yield*-i i lartë i bonove të thesarit, gjë që i drejton bankat në këtë formë investimi me përfitim të lartë dhe rrezik zero.

3.I. Përse ka ndërmarrë Banka e Shqipërisë nismën për zhvillimin e një fushate për rritjen e kreditimit të ekonomisë nëpërmjet sistemit bankar?

Tregu formal i huadhënies në Shqipëri, aktualisht është i vogël, pasi janë vetëm disa banka private të cilat japin kredi, kryesisht në valutë dhe pak në lekë. Gjithashtu, evidente ka qenë edhe cilësia e keqe e portofolit të huave (bankat shtetërore në portofolin e kredive kanë përqindje të larta të kredive me probleme). Niveli i lartë i këtyre kredive

është një faktor frenues për kreditimin dhe rritjen e besimit të bankave te klientët. Sipas të dhënave më të fundit të muajit mars, kreditë me probleme zënë 32.4 për qind të kredive gjithsej, në pjesën më të madhe në bankat shtetërore.

Mbi 97 për qind e kredive me probleme janë në bankat shtetërore. I lartë mbetet dhe niveli i huave të klasifikuara të humbura në masën rreth 7 miliardë lekë ose 35 për qind e huave të klasifikuara si me probleme. Nëse marrim parasysh dhe nivelin e interesave të klasifikuar si të humbur, rezulton se huatë e humbura gjithsej janë 10.6 miliardë lekë.

Një pjesë e konsiderueshme e këtyre huave janë trashëguar nga vitet e mëparshme, megjithatë një shifër e tillë vlerësohet si me rrezik për sistemin bankar.

Banka e Shqipërisë ka reaguar duke forcuar aftësinë e saj mbikëqyrëse për bankat e nivelit të dytë dhe zbatimin e kërkesave për krijimin e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga huatë.

Kjo situatë në portofolin e huave nuk do të thotë se gjithçka shkon keq në sistemin bankar. Përkundrazi, duke u mbështetur në raportimin e bankave për ecurinë e aktivitetit kreditues të ekonomisë, në tremujorin e parë të vitit 2000, vërehen dhe mjaft zhvillime pozitive në të.

Stoku i kredisë, si sistem bankar (duke përfshirë ristrukturimet dhe interesat e kapitalizuar të Hidrocentralit të Bovillës në Bankën e Kursimeve) është rritur 2.4 miliardë lekë në krahasim me fundin e vitit 1999. Ndërsa duke bërë përjashtimet e mësipërme, kredia është rritur 1.6 miliardë lekë. Është akorduar **kredi e re** nga bankat private dhe me kapital të përbashkët **3.4 miliardë lekë**, e shpërndarë në të tre afatet kohore (50.5 për qind afatshkurtër, 47.5 për qind afatmesme dhe 2 për qind afatgjatë) dhe mbi 80 për qind e saj është akorduar në valutë.


Theksojmë **rritjen e peshës specifike të kredisë afatmesme në stokun e kredisë**. Si sistem bankar, nga 27 për qind që ishte në fund të vitit 1999, ka arritur në 33 për qind në tremujorin e parë të këtij viti. Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm, duke u mbështetur në evidencën e kreditit, kemi paraqitur kredinë e re dhe rritjen e stokut të kredisë (për tremujorët e parë në tre vitet e fundit), nga ku duket qartë se po fillon një situatë e re në aktivitetin kreditues të bankave.



në miliardë lekë

	T1-1997	T1-1998	T1-1999	T1-2000
Kredia e re	1.1	0.7	1.5	3.4
Rritja e stokut të kredisë	0.5	0.2	0.5	1.5

Ecuria e stokut të kredisë dhe e kredisë së re
në tremujorët e parë të viteve 1997- 2000



Nëse do të vazhdojë me këtë ritëm kreditimi i ekonomisë, mendojmë se ky aktivitet bankar, aq shumë i diskutuar dhe aq i domosdoshëm në mbështetjen e biznesit privat, do të ketë përmirësime të dukshme e njëkohësisht do të sjellë efekte pozitive në zhvillimin e përgjithshëm të ekonomisë. Heqja e kufirit të kreditit duket se nga ana psikologjike, ka ndikuar në rritjen e kreditimit të ekonomisë.

Disa nga bankat tregtare, që kanë akorduar më shumë kredi, gjatë këtij tremujori janë:

- * **Banka Tirana**, rreth 1.0 miliardë lekë kredi, nga e cila 51 për qind është kredi afatmesme në valutë.
- * **Banka Italo-Shqiptare**, 0.5 miliardë lekë kredi afatshkurtër dhe 0.2 miliardë lekë kredi afatmesme, të dyja në valutë.
- * **Banka Alfa Kredit**, 0.4 miliardë lekë kredi afatmesme, 0.4 miliardë lekë kredi afatshkurtër dhe 1.9 milionë lekë kredi afatgjatë.
- * **Banka Fefad**, 0.5 miliardë lekë kredi afatmesme.
- * **Banka Amerikane e Shqipërisë** ka dhënë kredi të re 0.1 miliardë lekë (në të tre afatet kohore) si dhe rezultojnë një rritje e stokut të kredisë afatgjatë me 33 milionë lekë.

Kredia afatmesme kryesisht është dhënë në mbështetje të bizneseve në industrinë përpunuese, ndërsa, nga ana tjetër, vazhdojnë të akordohen kredi për tregtinë, ndërtimin, peshkimin, riparim automjesh etj.. Në tremujorin e dytë, do të fillojë të lëvrojë kredinë e parë edhe Banka Ndërtregtare, e cila ka projekte ambicioze në drejtim të këtij aktiviteti.

Banka qendrore nuk ka pushtet të detyrojë bankat e nivelit të dytë të rrisin nivelin e huadhënies. Këto banka, në bazë të ligjit në fuqi "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" kanë pavarësi në aktivitetin dhe vendimmarrjet e tyre. Ushtrimi i kontrollit nga Banka e Shqipërisë bëhet nëpërmjet vendimeve që ajo merr dhe instrumenteve që përdor. Duke qenë se këto vendime kanë rezultuar jo plotësisht të efektshme, banka qendrore është angazhuar në inicimin e një fushate për nxitjen e kreditimit në ekonomi.

3.II. Cilat janë hapat që do të ndiqen në vazhdim të fushatës për kreditimin e ekonomisë?

Së pari: Takimet.

Është shumë e rëndësishme që të diskutohet me komunitetin bankar e të biznesit përse nuk jepet kredi dhe çfarë pengesash hasin bankat në këtë proces. Për këtë qëllim:

- * në muajin maj, është organizuar një bisedë dhe janë shkëmbyer mendime me punonjës të Bankës së Shqipërisë për inicimin e fushatës së kreditimit nga ana e bankës qendrore, hapat konkretë dhe shpenzimet që do të ketë ajo për Bankën e Shqipërisë, si dhe synimet ku kërkohet të arrihet;
- * në fund të muajit maj, do të organizohen takime me bankat e nivelit të dytë për të diskutuar perspektivën e tyre për huadhënien, vështirësitë që ato kanë hasur dhe hasin në procesin e kreditimit dhe kërkesat që kanë ndaj Bankës së Shqipërisë. Gjithashtu, në këto takime do t'u bëhet e qartë bankave, se Banka e Shqipërisë, fillimisht do të botojë të dhëna të agreguara për sistemin bankar dhe më vonë të veçanta për secilën bankë. Mendojmë, që në këto takime, do të ndihmohemi me pjesëmarrje edhe nga përfaqësues të Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat;
- * në fillim të muajit qershor, do të organizohen takime me komunitetin e biznesit, duke kontaktuar me Unionin e Investitorëve dhe Dhomën e Tregtisë;
- * në muajin qershor, do të organizohet një takim i përbashkët i



Bankës së Shqipërisë, Klubit të Bankierëve dhe shoqatave kryesore të biznesit.

- * Mund të bëhet një takim diskutimi, midis Bankës së Shqipërisë dhe Klubit të Bankierëve për kredinë konsumatore. Kjo formë kredie mund të nxitet fillimisht për shtresa të sigurta popullore dhe me normë interesi (për rrjedhojë edhe normë fitimi) më të ulët. Një gjë e tillë do të nxirrte në pah dhe do të çonte në sensibilizimin e popullsisë për të mirat që ka çdo qytetar kur është një klient i bankës, jo vetëm si depozitues, por dhe si kredimarrës.

Para çdo takimi mund të bëhen njoftime në shtyp dhe pas tyre të përgatitet e të publikohet një përmbledhje e diskutimeve nga ana e Bankës së Shqipërisë.

Së dyti: Transparenca e aktivitetit të kredidhënies.

- * Plotësimi i disa pamfleteve (fletëpalosjeve) për kushtet që duhet të plotësojë çdo klient për të marrë kredi. Jo në të gjitha bankat tregtare ekziston një formë e tillë e transparencës. Zakonisht, në bankat e huaja, ka një vend të dukshëm pranë sporteleve, ku çdo njeri shkon dhe merr shpjegimet për produktet që i interesojnë.
- * Gjithashtu, çdo bankë duhet të ketë të gatshme në çdo kohë, kërkesat që klienti duhet të plotësojë për të aplikuar për marrjen e kredisë. Këto kërkesa duhet të jenë të klasifikuara sipas rasteve (shuma, lloji i biznesit, ditët që duhen për shqyrtim, takimin e ardhshëm me klientin, etj.). Në këtë mënyrë, çdo klient kur aplikon e ka kryer punën përgatitore dhe oficerët e kreditit të bankës plotësojnë më tej procedurat për pjesën e tyre (anën formale të pranimit të dokumenteve).
- * Publikimi i të dhënave për aktivitetin kreditues të institucioneve financiare jobankare, duke u mbështetur në aktet ligjore e nënligjore dhe informacionet.
- * Si mund të kërkojë banka planin e biznesit të klientit. Në vende të ndryshme, bankat tregtare japin broshura në të cilat tregohet se si mund të organizohet plani i biznesit. Ky është një rekomandim që duhet të diskutohet në komunitetin bankar shqiptar. Banka Fefad me oficerët e kreditit organizon vetë planet e biznesit duke përcaktuar në kooperim me klientin, skedulin e shlyerjes; ndërsa Banka Amerikane e Shqipërisë rekomandon, për klientët që e

dëshirojnë, një organizatë të ngritur nga IFDC (e cila harton planet e biznesit) si një element i ndërmjetësit financiar.

* Monitorimi i ngushtë i aktivitetit të njësive të tregut joformal të kreditit. Gjithashtu, mund të nxiten shoqatat e kreditit, që të ndihmojnë në kreditimin e rajoneve të caktuara, të vogla të vendit, apo dhe të aktiviteteve të vogla dhe nëse janë të suksesshme atëherë ato kanë perspektivë të shndërrohen në banka rajonale zhvillimi. Aktualisht, në vendin tonë veprojnë disa të tilla.

- Botimi, nga Banka e Shqipërisë, i të dhënave për normat mesatare të kredive të reja të dhëna nga bankat, së bashku me shumat e agreguara.
- Kryerja e studimeve përkatëse lidhur me investitorët e huaj në Shqipëri dhe mundësitë që ata kanë për të marrë kredi nga bankat tregtare.

Së treti: Aspekte të tjera.

- Formimi i institucionit të informacionit të kredive, i cili do të lehtësonte punën e bankave të nivelit të dytë në drejtim të njohjes sa më mirë të klientëve, që duan të operojnë me to.
- Nxitja e dhënies së informacioneve të herëpashershme nga Agjencia e Trajtimit të Kredive, lidhur me procedurat e kthimit të kredive, kushtet lehtësuese për klientë që respektojnë afatet etj., që do të eliminojnë përfundimisht idenë e moskthimit të kredive.

3.III. Synimet e fushatës së kreditimit të ndërmarrë nga Banka e Shqipërisë.

Si përfundim, kjo fushatë, synon:

- të edukojë biznesin shqiptar, nëpërmjet takimeve, publikimeve, asistencës dhe konsulencës financiare profesionale që në fazën e krijimit të shoqërive (sh.p.k. ose sh.a.), studimeve të ndryshme ekonomike, dokumentacionit të domosdoshëm të kërkuar nga bankat etj., pasi "frika" e bankave ndaj bizneseve vjen edhe nga mungesa e informacionit të mjaftueshëm për njeri-tjetrin;
- të bëjë të njohur te klientët se si mund të merret kredi në bankë, çfarë kushtesh janë të detyruar të plotësojnë bizneset dhe individët për të qenë huamarrës në banka;



- të identifikojë disa nga shkaqet, që mund të shkaktojnë kufizim në aktivitetin kreditues dhe në vijim të merren masat përkatëse për të reduktuar pengesat.

Nisur nga rëndësia që ka për ekonominë aktiviteti huadhënës, Banka e Shqipërisë do të angazhohet me burimet e saj njerëzore dhe do të mbështesë financiarisht këtë fushatë kreditimi për të kontribuar sadopak në përmirësimin e funksionimit të këtij tregu.

Megjithatë, është detyrë edhe e institucioneve të tjera që të kontribuojnë për krijimin e klimës së nevojshme për kreditim.

Vendi kërkon rend e qetësi që edhe bizneset të jenë të interesuara për investime, edhe bankat të ndjehen të sigurta në financimin e këtyre investimeve.

Kërkohet forcim i zbatimit të ligjit dhe i sistemit gjyqësor.

Efektshmëria në zbatimin e ligjit është e lidhur ngushtë me ecurinë e kreditimit pasi krijon mbështetjen dhe garancinë e nevojshme që paratë e dhëna do të kthehen në bankë.

Forcimi i kontrollit të organeve tatimore, gjithashtu, ka vlerën e vet. Duke minimizuar mbajtjen e dy bilanceve nga ana e bizneseve, ato kthehen në kliente të besueshme për bankat.

4. ZHVILLIMI I STATISTIKAVE DHE RITJIA E TRANSPARENCËS.

Në nëntor të vitit 1999, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi strategjinë e zhvillimit afatmesëm të Bankës së Shqipërisë.

Nga ky dokument dua të theksoj, edhe një herë, dy objektiva të rëndësishëm strategjikë për bankën: përmirësimin e statistikave dhe ritjen e transparencës.

4.1. Zhvillimi i statistikave.

Vazhdimisht, në deklaratat dhe opinionet e saj, Banka e Shqipërisë ka tërhequr vëmendjen për gjendjen relativisht të pazhvilluar në të cilën janë sot statistikave në Shqipëri. Problemet me statistikave kanë të bëjnë me mungesën totale të tyre ose me ekzistencën e statistikave të varfra dhe shpesh kontradiktore të publikuara ose jo nga subjekte shtetërore e

private. Kjo gjendje e statistikave, praktikisht sjell pengesa në të kuptuarin e ekonomisë shqiptare, në analizimin e saj, në parashikimin dhe marrjen e vendimeve. Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë, siç është deklaruar tashmë, inicioi zbatimin e dy projekteve në fushën e statistikave. Projektet po zbatohen me asistencën e FMN. Madje Shqipëria është zgjedhur si projektpilot për anëtarësimin në sistemin e Përgjithshëm Standard të Shpërndarjes së të Dhënave (GDDS).

Banka e Shqipërisë, me angazhimin në këtë fushë, ka projektuar mbajtjen e një konference kombëtare, në bashkëpunim me INSTAT, me temë "Informacioni statistikor në Shqipëri", në datat 2-3 nëntor. Mbajtja e konferencës ka për synim:

- të sensibilizojë autoritetet më të larta shtetërore, komunitetin e biznesit dhe publikun mbi rëndësinë e jashtëzakonshme që kanë statistikave për një vend;
- të kërkojë nga këto grupe që të mbështesin procesin e zhvillimit të statistikave dhe publikimin e tyre;
- të prezantojë statistikave që prodhohen dhe publikohen nga Banka e Shqipërisë;
- të vlerësojë shkallën e përdorimit të statistikave nga komuniteti i biznesit;
- të sigurojë informacionin më të madh të mundshëm mbi statistikave ekzistuese, burimet e informacionit dhe shkallën e besueshmërisë duke përfunduar në përpilimin e një harte statistikore, që nënkupton renditjen e statistikave që prodhohen në Shqipëri duke i vënë referencën e subjektit që i prodhon dhe të subjektit (subjekteve) që i publikon;
- të propozojë rrugët për zhvillimin e statistikave në të ardhmen.

4.II. Rritja e transparencës së Bankës së Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë e ka shpallur vitin 2000 si vitin e transparencës (apo si vitin ku do të punohet me intensitet për të rritur transparencën) për veprimtarinë e saj.

Në rradhë të parë, Banka e Shqipërisë është e angazhuar të përmbushë, në maksimumin e mundshëm, standardet e përpunuara nga FMN për transparencën në fushën e politikave financiare dhe monetare. Them në maksimumin e mundshëm, sepse duhet kuptuar që niveli i zhvillimit në sektorin bankar e financiar, bën të pamundur zbatimin e disa lloj standardeve.



Duke rritur transparencën, rritet përgjegjshmëria e veprimeve dhe vendimeve të bankës qendrore, pasi aktiviteti i saj i nënshtrohet një debati publik dhe i krijohen mundësi ballafaqimi për të kuptuar sa të drejta janë vendimet e marra apo politikave e ndjekura, a duhen korrigjuar ato, ku, kur dhe si.

Rritja e transparencës me institucionet e tjera shtetërore ndihmon në koordinimin e politikave dhe aktiviteteve, ndihmon në rritjen e shkallës së konsultimit.

Rritja e transparencës, sidomos me median dhe publikun, rrit shkallën e njohjes së Bankës së Shqipërisë si institucion dhe i jep mundësi asaj të rrisë autoritetin dhe ndikimin e vet edhe mbi institucionet e tjera shtetërore. Ajo që është më e rëndësishme, rrit masën e përkrahësve të Bankës së Shqipërisë.

Rritja e transparencës do t'i shërbejë edhe një qëllimi tjetër atij "të edukimit" të publikut. Për shumë arsye, media dhe publiku janë pak të ambientuar me çështjet e natyrës ekonomike. Nëse rritet shkalla e informimit të publikut dhe thjeshtësia e dhënies së informacionit, gjykimi mbi politikave dhe vendimet ekonomike do të bëhet pjesë e pandashme e veprimtarisë së këtyre grupeve si dhe e bizneseve dhe ekonomistëve, do të disiplinojë sjelljen e tyre ekonomike dhe do t'i orientojë ata. Në fund të fundit kjo i shërben Bankës së Shqipërisë për të ndërtuar dhe vënë në funksionim efikas mekanizmat e transmissioinit në ekonomi të vendimeve të saj. Nëse askush nuk kupton pse merret një vendim i politikës monetare, asnjë vendim nuk e ka të sigurt suksesin e tij dhe sinjalet që merr banka qendrore nga mjedisi ekonomik shtrembërohen duke vështirësuar marrjen e vendimeve të tjera.

Së fundi, rritja e transparencës nga Banka e Shqipërisë do të shërbejë edhe për ndërrimin e mentalitetit dhe të traditës së "ruajtjes së sekreteve" dhe "monopolit mbi informacionin" ose "pushtetit mbi informacionin". Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë e ndjen të nevojshme të kërkojë nga media të vlerësojë angazhimin e bankës qendrore për të rritur transparencën e saj, të respektojë veprimet që ndërmerret banka qendrore dhe të mos përpiqet të spekulojë me to.

Ne jemi të vetëdijshëm që kjo kërkon dhe kohën e nevojshme për t'u krijuar. Por, gjithashtu, dimë se nëse Banka e Shqipërisë, në rradhë të parë, ka një qëndrim korrekt, sigurisht që edhe reagimi i medias do të jetë gjithnjë e më serioz.

Gjithashtu, Banka e Shqipërisë apelon për bizneset, individët apo çdo subjekt tjetër prej të cilit kërkohet informacion statistikor, të rrisin shkallën e gatishmërisë për dhënien e informacionit të kërkuar. Qëllimi i mbledhjes së të dhënave nuk është ndëshkimi i këtyre subjekteve. Të dhënat përdoren vetëm për qëllime studimore dhe për hartim politikash.

Kuptohet, sa më i plotë dhe i mirë të jetë informacioni i marrë aq më të mira do të jenë vendimet dhe politikat e autoriteteve, që në fund të fundit përmirësojnë mjedisin për individët dhe bizneset. Prandaj, Banka e Shqipërisë kërkon më tepër bashkëpunim nga qytetarët dhe subjektet private.

4.III. Mbështetja financiare e Bankës së Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë, nisur nga pozicioni i favorshëm financiar që ka dhe pavarësia në përdorimin e mjeteve të saj financiare, është e angazhuar që të financojë fushata të tilla si ajo për bonot e thesarit, për kreditin, zhvillimin e statistikave apo edukimin e publikut, pavarësisht se një pjesë e tyre është detyrë edhe e institucioneve të tjera shtetërore. Duke vepruar në këtë mënyrë besojmë se Banka e Shqipërisë do të bëhet nxitëse edhe për këto institucione.

5. ROLI I BANKËS SË SHQIPËRISË NË DREJTIM TË PËRMIRËSIMIT TË SISTEMIT TË PAGESAVE.

Nxitja e funksionimit normal të sistemit të pagesave përbën një nga detyrat ligjore të Bankës së Shqipërisë, në funksion të realizimit të objektivit kryesor të saj, arritjes dhe ruajtjes së stabilitetit të çmimeve. Për të realizuar këtë detyrë, ligji i njeh Bankës së Shqipërisë të drejtën e vendosjes së rregullave dhe të procedurave për kryerjen e pagesave, të organizimit të shërbimit të kleringut dhe rregullimit të këtyre pagesave si dhe atë të mbikëqyrjes së sistemit të pagesave në Shqipëri.

Banka e Shqipërisë është angazhuar, në vazhdimësi, për të përmbushur detyrat e saj ligjore në lidhje me sistemin e pagesave si dhe përgjegjësitë, që rrjedhin prej tyre. Ky angazhim, konsiston nga njëra anë në kryerjen e përmirësimeve të procedurave dhe anës rregullatore të sistemit të pagesave dhe, nga ana tjetër, në konceptimin dhe ndjekjen e të gjitha hapave të nevojshëm për zhvillimin dhe përmirësimin konkret të tij. Aktualisht, Banka e Shqipërisë kryen dy funksione të rëndësishme në sistemin e pagesave në vend: ajo u ofron bankave të nivelit të dytë shërbimin e kleringut të pagesave të klientëve në lekë dhe shërbimin e



rregullimit të pagesave ndërbankare në llogaritë e bankave të nivelit të dytë pranë saj.

5.I. Sistemi i kleringut.

Bazuar në eksperiencën e vendeve të zhvilluara, organizimi i shërbimit të kleringut nuk përbën një aktivitet themelor dhe përgjegjësi direkte të Bankës Qendrore. Në përgjithësi, në këto vende, janë vetë bankat të cilat, në bashkëpunim me operatorë të tregut privat, organizojnë marrëveshjet dhe sistemet përkatëse të kleringut, të cilat ofrojnë një mënyrë të shpejtë të kryerjes së pagesave të klientëve.

Organizimi i këtij shërbimi, nga Banka e Shqipërisë, është diktuar nga një sërë faktorësh specifikë si: mungesa e eksperiencës së një shërbimi të tillë më parë në Shqipëri, mungesa e konsolidimit të aktivitetit të vetë bankave të nivelit të dytë, niveli i ulët i përdorimit të instrumenteve *jocash* të pagesës nga ana e individëve (që bën që bankat të mos ndiejnë ndonjë presion nga ana e tregut për të investuar vetë në këtë aktivitet) etj..

Banka e Shqipërisë ka marrë masa për të përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme cilësinë e këtij shërbimi dhe që nga viti 1999 ka futur në përdorim Swiftin për shkëmbimin e të gjitha urdhërpaguesave të klientëve në klering. Nga ana tjetër, edhe baza rregullatore e këtij shërbimi ka qenë subjekt i rishikimit e përmirësimit të vazhdueshëm.

Banka e Shqipërisë, synon që të ndërmarrë masa të vazhdueshme për rritjen e shkallës së automatizimit të këtij sistemi, me qëllim që të lehtësohet kryerja e pagesave nëpërmjet tij, të shkurtohen afatet e lëvizjes fizike të dokumenteve etj.. Në këtë mënyrë, gjykohet se mund të krijohen kushte të mjaftueshme për të ndikuar në rritjen e kërkesës së individëve dhe bizneseve për përdorimin e instrumenteve të pagesës *jocash*. Me plotësimin e këtyre kushteve, Banka e Shqipërisë mund të konsiderojë nevojën e kalimit të këtij shërbimi ndaj vetë sistemit bankar, duke hequr dorë kështu nga operimi i drejtpërdrejtë i tij dhe duke luajtur rolin e autoritetit mbikëqyrës të këtij sistemi.

5.II. Shërbimi i rregullimit të transaksioneve të bankave të nivelit të dytë në llogaritë pranë Bankës së Shqipërisë.

Mbajtja e llogarive pranë Bankës së Shqipërisë është një detyrim ligjor për bankat e nivelit të dytë. Në këto llogari përqendrohet i gjithë likuiditeti

ditor i tyre dhe regjistrohen të gjitha transaksionet e kryera nga ana e bankave. Në funksion të ruajtjes së stabilitetit të sistemit bankar, banka qendrore është e interesuar që mënyra e funksionimit të këtyre llogarive të minimizojë rrezikun e likuiditetit dhe të kreditit në sistemin bankar.

Për të përmbushur këtë objektivi, Banka e Shqipërisë, ka marrë, në vazhdimësi, masa për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve të ofruara prej saj në këto llogari. Kështu, është realizuar unifikimi i llogarisë rrjedhëse me atë të rezervës së detyrueshme, është lejuar mobilizimi i kësaj të fundit deri në masën 5 për qind për nevoja ditore likuiditeti etj.. Rritja e volumit të transaksioneve ndërbankare, rritja e aktivitetit të bankave të nivelit të dytë në bono thesari, rritja e vetë numrit të bankave të nivelit të dytë etj. janë faktorë që ndikojnë në rritjen e rrezikut të likuiditetit dhe të kreditit të sistemit bankar dhe bëjnë të domosdoshëm përmirësimin e cilësisë së administrimit të këtyre llogarive në bankën qendrore. Pikërisht, me qëllim vënien nën kontroll dhe minimizimin e riskut, rritjen e fleksibilitetit të menaxhimit të likuiditetit, rritjen e shpejtësisë së kryerjes së transaksioneve ndërbankare etj., Banka e Shqipërisë ka vendosur që të implementojë pranë saj sistemin RTGS (**Real Time Gross Settlement System**). Ajo është duke bashkëpunuar me Bankën Botërore për implementimin e këtij sistemi dhe sipas diskutimeve të deritanishme, pritet që ky sistem të jetë në funksionim në fillim të vitit 2002. RTGS do të përbëjë mekanizmin bazë të sistemit të pagesave në Shqipëri. Përveç, ndikimeve të sipërpërmendura, ai do të mbështesë edhe përdorimin e instrumenteve indirekte të politikës monetare nga ana e Bankës së Shqipërisë, rritjen e aktivitetit të tregjeve financiare si dhe do të ofrojë një mekanizëm të sigurt për rregullimin e transaksioneve të kryera me instrumente të reja pagese si kartat etj..

5.III. Instrumentet e pagesës.

Tipi i instrumenteve të pagesës që individët dhe bizneset kanë në dispozicion për kryerjen e pagesave konsiderohet përgjegjësi direkte e bankave të nivelit të dytë. Ato varen nga kërkesa e publikut për instrumente pagese *jo cash*, nga lehtësia dhe komoditeti në përdorim (aftësia për të zëvendësuar *cash-in*), tipi i klientelës në të cilën banka kërkon të fokusojë shërbimet e saj etj..

Pavarësisht nga fakti që Banka e Shqipërisë nuk ka ndonjë përgjegjësi direkte në lidhje me instrumentet e pagesës që përdoren, në pozicionin e autoritetit mbikëqyrës të sistemit të pagesave, ajo ka nxitur bankat për të futur në përdorim instrumente të reja pagese. Kështu, disa nga



bankat e nivelit të dytë kanë ndërmarrë inisiativa dhe përpjekje për të futur në përdorim instrumente të reja pagese si, kartat për tërheqjen e *cash*-it në sportelet automatike (ATM) apo kryerjen e pagesave dhe të veprimeve me llogarinë në mënyrë elektronike (electronic banking / home banking). Gjithashtu, nga ana e dy prej bankave tregtare, janë futur në përdorim në tregun shqiptar edhe shërbimet në karta të dy kompanive të mirënjohura, DINERS CLUB dhe VISA.

Gjithësesi, Banka e Shqipërisë vëren se përdorimi këtyre instrumenteve nga publiku i gjerë është i kufizuar. Pavarësisht nga mentaliteti i trashëguar dhe arsye të tjera, që ndikojnë në përdorimin e gjerë të *cash*-it në Shqipëri, Banka e Shqipërisë gjykon që reduktimi i *cash*-it duhet shndërruar në një objektiv afatmesëm. Vendosja dhe deklarimi, në avancë, i këtij objekti do t'u japë kohë bankave të krijojnë infrastrukturën e nevojshme për të përballuar një fluks më të madh klientësh dhe aktiviteti. Nga ana tjetër, ai do t'u japë kohë vetë strukturave shtetërore për të përcaktuar hapat që duhen hedhur me qëllim realizimin e këtij objekti.

5.IV. Konkluzione.

1. Banka e Shqipërisë e konsideron tepër të rëndësishëm implementimin e sistemit RTGS. Ajo do të vazhdojë të jetë direkt e angazhuar në ndjekjen e procedurave të nevojshme dhe implementimin këtij sistemi në bankë brenda afateve të parashikuara.
2. Banka e Shqipërisë do të vazhdojë t'i kushtojë rëndësi përmirësimit të cilësisë së shërbimit të kleringut të organizuar prej saj. Në të njëjtën kohë, ajo synon të mbështesë inisiativat e përbashkëta të sistemit bankar shqiptar për të organizuar këtë shërbim në mënyrë të pavarur nga Banka e Shqipërisë.
3. Banka e Shqipërisë mbështet iniciativat e bankave të nivelit të dytë për futjen në përdorim të instrumenteve të reja të pagesës. Ajo do të vazhdojë të ushtrojë ndikimin e saj, si autoriteti mbikëqyrës i sistemit të pagesave, për shtrirjen e këtyre inisiativave dhe krijimin e infrastrukturës së përshtatshme për mbështetjen e tyre.
4. Banka e Shqipërisë do të vazhdojë t'i kushtojë rëndësi përmirësimit të bazës ligjore e rregullatore të sistemit të pagesave. Ajo do të jetë vazhdimisht e angazhuar që të sigurojë mbështetjen e duhur ligjore

e rregullatore ndaj çdo iniciative që ajo vetë apo sistemi bankar do të ndërmarrë në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës së kryerjes së pagesave në Shqipëri.

5. Pakësimi i sasisë së *cash*-it në ekonominë shqiptare, del jashtë përgjegjësisë dhe mundësisë së Bankës së Shqipërisë. Ajo gjykon se në këtë drejtim është i nevojshëm një bashkëpunim dhe angazhim në nivel qeveritar.